



**Republika e Kosovës – Republika Kosova**  
*Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa*  
*Izborni Panel za Žalbe i Predstavke*

**A nr. 452/2013**

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtaret Hasan Shala kryesues, Ferit Osmani, dhe Rafet Haxhaj anëtarë, duke vendosur përkitazi me ankesën e subjektit politik Aleanca Kosova e Re (AKR) dega në Gjakovë paraqitur kundër disa qendrave të vendvotimeve të komunes së Gjakovës për shkak të vonësive në hapjen e vendvotimeve dhe numrin më të vogël të fletvotimeve, në Zgjedhjet Lokale të 03 Nëntorit 2013, në seancën e panelit të mbajtur më 07.11.2013, mori këtë:

**V E N D I M**

**Refuzohet** si i pabazuar ankesa e Aleances Kosove e Re (AKR) dega në Gjakovë

**Arsyetim**

Anëtarët e subjektit politik AKR-se dega në Gjakovë më datën 03.11.2013 kanë paraqitur ankesë në PZAP, në të cilën theksojnë se qendrat e vendvotimeve në komunën e Gjakovës në përgjithësi janë hapur më 20 minuta vonë, duke theksuar vonësin prej 40 minutash në qendrën e votimit Zekirja Rexha, në qendrën e votimit Yll Morina 20 minuta më vonë, kurse në qendrën e votimit Kadri Kusari procesi i votimit ka filluar më 30 minuta vonë. Më tutje parashtresit e ankesës deklarojnë se nga të gjithë komisionerët dhe vëzhguesit e AKR-se është raportuar numër më i vogël i fletvotimeve në raport me numrin e qytetarëve në listat e nënshkrimeve. Kadri Kusari vendvotimi (0204c/04) 577 votues në listë, 550 fletvotime, Mustafa Bakija vendvotimi (0202c/04R) votues në listë 847, 800 fletvotime, Bishtazhin vendvotimi (0208c/2) votues në listë 949, 900 fletvotime, prap Bishtazhin (0208c/4) votues në listë 795, 750 fletvotime, Lipovec vendvotimi (0209c/2) votues në listë 871, 850 fletvotime

PZAP-i, pasi shqyrtoi ankesën gjeti se:

**Ankesa është e pabazuar**

Më nënin 118.4 LZP-se, parashihet se: “Mund të apelojnë vendimet e PZAP-it sikurse PZAP-i mund të rishikojë cilindo nga vendimet e marra pas prezantimit të fakteve të reja nga pala e interesuar”.

Ankuesit në ankesen e tyre pretendojnë ne parregullsi ne procesin zgjedhor dhe ne manipulim te votave. PZAP-i konstaton se keto pretendime ankimore jane të pabazuara pasi që parashtuesi i ankesës nuk ka ofruar asnjë prove shtese dhe deshmi bindese qe eshte bere nje shkelje e tille, prandaj ne kuptim te nenit 118 paragrafi 1 te LZP-se, si dhe neni 3.6 pika c) te rregullores se PZAP-i lidhur me ankesen e larte permendur u vendos si ne dispozitiv te ketij vendimi.

**Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa**

A nr. 452/2013 më datën 07.11.2013

**Kryesuesi i Panelit  
Hasan Shala**



**Këshillë juridike:** Ndaj ketij vendimi mund te paraqitni ankese ne Gjykatën Supreme te Republikës se Kosoves brenda njezetekater (24) orëve nga momenti i marrjes se vendimit nga PZAP-i.